



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E PROKURORËVE
KOMISIONI I VOTIMIT**

Tiranë, më 13.10.2023

PROCESVERBAL

**I PROCESIT TË VOTIMIT NGA MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E
PROKURORËVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE PROKUROR TË
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Sot, më 13.10.2023, ora 12.40, në Tiranë, mbahet ky procesverbal për të dokumentuar votimin nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve prokuror për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 115, pika 3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve në përputhje me rendin e ditës, votoi për zgjedhjen e 2 (dy) prokuroreve pranë gjykatave të shkallës së parë si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe 1 (një) prokurore pranë gjykatave apelit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Nga lista emërore prej 243 prokuroresh u nënshkrua dhe vërtetohet se morën pjesë në mbledhje 234 (dyqind e tridhjetekater) prokurorë të të gjithë niveleve.

Votimi nisi në orën 11.10 dhe përfundoi në orën 12.40.

U hap kutia e votimit, për kandidatët prokuror të prokurorive të apeleve duke verifikuar kodet e administruara nga komisioni i votimit dhe rezultoi se përputhen me kodet e vendosura para fillimit të votimit.

Nga numërimi rezultoi se numri total i votave të hedhura në kuti është 234 (dyqind e tridhjetekater). Nga numri total i votave, rezultoi 228 (dyqindë e njezetetete) vota janë të vlefshme dhe 6(gjashte) vota janë të pavlefshme.

Nga numërimi i votave të vlefshme, të lexuara e shfaqura për gjithë të pranishmit, rezulton të jetë votuar për kandidatët, si vijon:

- znj. Aferdita Ndoi , 106 (njeqindeegjashte) vota;
- z. Moisi Duda. 122 (njeqindenjezeedy) vota;

Në përputhje me nenin 115/5 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, shpallet fitues, për prokurorit e Apelit kandidati **Moisi Duda**

U hap kutia e votimit, për kandidatët prokuror të prokurorive të shkallëve të para duke verifikuar kodet e administruara nga komisioni i votimit dhe rezultoi se përputhen me kodet e vendosura para fillimit të votimit.

Nga administrata ishin përgatitur 500 fletë votimi.

Nga numërimi rezultoi se numri total i votave të hedhura në kuti është 468 (katerqindegjashtee). Ngelen fletë votimi te papërdorura.


Nga numri total i votave, rezultoi se 407 (katerqindeeshtate) fletë votimi janë të vlefshme dhe 61 (gjashtedhjetenje) fletë votimi janë të pavlefshme.

Nga numërimi i votave të vlefshme, të lexuara e shfaqura për gjithë të pranishmit, rezulton të jetë votuar për kandidatët, si vijon:

- znj Edina Kurti 95 vota;
- znj. Edlira Bako 35 vota;
- znj. Elsa Miha 76 vota;
- znj. Olger Eminaj 103 vota
- z. Vate Staka 98 vota;

Në përputhje me nenin 115/5 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, shpallen fitues, për prokurorit e shkallës së parë kandidatet me numrin më të madh të votave, te cilet janë **z.Olger Eminaj** dhe **z.Vate Staka**.

Proceverbali mbahet në 2 (dy) kopje, u lexua e u gjet i rregullt dhe firmoset pa vërejtje nga Komisioni i Votimit.



Procesverbali, vendimi dhe gjithë materialet e votimit i dorëzohen Prokurorit të Përgjithshëm, sot në datë 13.10,2023.

Procesverbali mbyllet në orën 14.50.

KOMISIONI I VOTIMIT

ANËTAR

KRYETAR

ANËTAR

ALAMA MUCA

KASEM BERBERI

ALFRED PROGONATI

